

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



AKTIVITETI : PRODHIME BETONI

SUBJEKTI "GJONI-AN" sh.p.k.

Adresa e objektit:

Tiranë, Zall Herr, Lagja Pinar.

Permbajtja

1. Hyrje	3
2. Përshkrimi i vëndit ku zhvillohet aktiviteti. Mjedisi natyror.....	5
a. Vëndndodhja	5
b. Cilesia e terrenit (toka, habitatete, flora e fauna).....	7
c. Aspekti hidrologjik e gjeomorfologjik i zonës.....	8
ç. Ajri, klima	8
d. Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike	9
dh. Pejsazhi dhe topografia	9
e. Kuadri ligjor, i politikave, planeve etj	9
3. Përshkrimi i projektit	10
Qellimi i zhvillimit të projektit	10
Alternantivat e projektit	10
Teknologjia e aplikuar	10
3. Vlerësimi i ndikimeve ne mjedis	13
a. Ndikimi ne ujë.....	13
b. Ndikimi në ajer dhe klimë.....	14
ç. Ndikimet në florën, faunen dhe gjeologjinë.....	14
d. Ndikimit në energji	14
dh. Ndikimi në interesin publik	15
e. Ndikimi në degradime fizike.....	15
ë. Ndikimi në qarkullim të transportit.....	15
f. Ndikimi nga zhurmat	15
g. Ndikimi në përfitimin e tokës	15
gj. Ndikimi në estetikën mjedisore	16
h. Ndikimi në trashëgiminë kulturore	16
4. Masat per mbrojtjen e mjedisit	16
a. Administrimi i mbeturinave te ngurta	16
b. Masat per ujrata e perdorura	16
c. Zbutja e ndikimi ne ajer.	17
d. Minimizimi i zhurmave në mjedis.	17
dh. Shfrytezimi racional i burimeve natyrore	18
e. Kerkesat teknike, estetike e ekologjike	18
ë. Parandalimi i rreziqeve	19
5. Monitorimi	20
6. Konkluzione.....	21

1. Hyrje

Subjekti "GJONI-AN", prej kohësh ushtron aktivitetin e prodhimeve të betonit në objektin në Zall Herr, Lagjia Pinar, Tiranë. Në impiantin e instaluar për këtë qëllim prodhohen pllaka e bordura trotuari, tuba të seksioneve të ndryshme, shtylla vreshti, puseta, blloqe, ulluqe, oxhaqe, kuneta të ndryshme, të gjitha këto prej betoni. Për aktivitetin e prodhimeve të betonit, ky subjekt është pajisur me autorizim mjedisor të lëshuar me 30.12.2013, PN-6667-12-2013 nga QKL, me akt miratimi të datës 23.12.2013, me nr. vendimi 12, nr. protokoli 659, e me nr. identifikues LC-2315-19.2013 të ARM-së Qarkut Tiranë.

Bazuar në VKM me nr. 419, datë 25.06.2014, referuar Kreut III, pika "dh", subjekti duhet të ndjekë procedurat për zhvillimin e degjësës me publikun dhe në vijim hartimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me leje të re mjedisore.

Për këtë qëllim, bazuar në kërkesën e këtij subjekti është hartuar ky raport i përmbledhur i VNM nga ku jemi mbështetur në:

- Dokumentacionin tekniko-logjor të subjektit për aktivitetin që kryen;
- Vrojtimi i të gjithë aspekteve mjedisore të zonës e të sipërfaqes e të detajeve të vetë objektit;
- Analizimi i detajuar i të dhënave të skemës teknologjike që aplikon, të treguesve të prodhimit;
- Respektimi nga ana e subjektit i kushteve të parashtruara në autorizimin mjedisor të meparshëm;
- Shkarkimet aktuale në mjedis dhe masat e marra në zbutjen e eliminimit të tyre.

Po kështu kjo përmbledhje e raportit të VNM-së mbështetet në kuadrin ligjor mjedisor për Shqipërinë, konkretisht:

- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave "Për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore";
- Udhezim nr.1 datë 03.03.2009 " Per detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis ";
- Vendim nr. 13 datë 4.1.2013 " Per miratimin e rregullave, të përgjegjesive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis";
- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" me amendimet përkatëse;
- Ligji nr.10448, datë 14.7.2011" Për lejet e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligji nr.10440 datë 7.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

- VKM nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore;
- VKM nr. 912, datë 11.11.2015 "Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis".
- Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar;
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte";
- VKM nr.99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre;
- Ligji nr.9115 datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis".
- VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga qkl-ja";
- Ligji me nr. 8906, datë 6.06.2002 "Për zonat e mbrojtura";
- Ligji me nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar;
- Ligji nr.10 237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- VKM nr. 564, datë 3.7.2013 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës".

Qëllimi i raportit të VNM është:

- Identifikimi dhe parashikimi i ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative në mjedis si rezultat i objektit të ndërtuar e aktivitetit që zhvillon ;
- Evidentimi i sigurimi i masave që zbusin ose kompensojnë ndikimet negative në mjedis si rezultat i këtij projekti të zbatuar.
- T'ë beje të njohur veçoritë natyrore të zonës ku ndodhet me qëllim respektimin e masave që mbrojnë cilësitë natyrore të trashëguara të tyre.
- Të ndergjegjesohet subjekti për respektimin e kërkesave që kanë të bejnë me ushtrimin e aktivitetit në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në legjislacionin mjedisor, për një zhvillim të qëndrueshëm sa më miqësor me mjedisin.

2. Përshkrimi i vëndit ku zhvillohet aktiviteti. Mjedisi natyror.

a. Vëndndodhja.

Linja e prodhimit të artikujve prej betoni e shoqërisë "GJONI-AN", ndodhet në anë të një rrugë të paasfaltuar që të dërgon në fshatin Pinar, të Njesisë Administrative Zall Herr, Bashkia Tiranë. Subjekti ka në pronësi një sipërfaqe prej 4730 m² (nga keto ndertesa 1658 m²), zona kadastrale 2961, me nr. pasurie 139/41. Kjo pronë kufizohet ne:

- Veri me pronën me numër 139/8;
- Lindje me pronën me numër 139/19;
- Jug me pronën me numër 139/5;
- Perëndim me pronën me numër 236.



Fig. 1 - Pamje nga ortofoto e vendodhjes së linjes së prodhimit të betonit



Fig. 1. Vendodhja e objekti (imazh ortofoto i vitit 2015)




Fig. 2. Vendodhja e objekti.

b. Cilesia e terrenit (toka, habitatete, flora e fauna).

Zona rreth objektit është e lirë pa zhvillime ndertimore të asnjë karakteri urban apo rural. Ky objekt ndodhet në largësi të konsiderueshme nga banesat e fshatrave periferike.

Linja e prodhimeve të betonit ndodhet në një terren të rafshët i cili përfaqëson tarracime nga depozitimet aluvionale të lumit të Terkuzës i cili kalon në anën jugperendimore të tij. Terreni sipërfaqësor përfaqësohet nga suargjila të lehta deri të mesme, me ngjyrë kafe në bezhe e me lagështirë. Falë afërsisë me ujrat nëntokesore të shtresës sipërfaqësore e përbërës së saj, ajo mbart një bimësi tipike të zonës së shkurretave mesdhetare.

Terreni ku vendoset objekti nuk shquhet për habitate me vlera të veçanta natyrore, e që të mbartë cilësi të dallueshme për biodiversitet. Bimësinë natyrore në zonat periferike të objektit, është kondicionuar nga niveli relativisht i ulët i terrenit, afërsia e ujrave nëntokesore, tipare të tjera edafike e lënia pas dore e përdorimit për kultivim etj.

Në sipërfaqet e sheshta periferike të këtij objekti takohen bimë të familjeve graminore si kuqela e ravenes (*Erianthus ravenua* P.B.), si dhe mendra (*Menta piperita* L.) mendra gjethëgjate (*Mentha longifolia* L.), menta e eger (*Menta pulegium* L.) menta e ujit, (*Menta aquatica*), bargjaku (*Lythrum salicaria* L.).

Janë të instaluar gjithashtu sidomos në vendet me të ngritura dhe bimët e familjes së kompoziteve si thundermushka (*Tussilago farfara* L.), kamomili i qenit (*Anthemis cotula*), cikorja (*Cichorium intybus* L.), lule dhensh (*Bels perenis* L.) e bime të tjera si hermana, (*Rubus fruticosus* L.), kin fushe (*Erithrea centarium*), Podiqja e eger (*Agrimonia eupatoria*), terfili i arave (*Trifolium arvense*) etj. Në brigjet e lumit të Terkuzës takohen dhe konopica (*Vitex agnus-castus* L.), marina (*Tamarix parviflora* DC) si dhe rriten drurë të gjinise *Salix*, *Populus*, *Ulmus*, *Platanus* etj.

Nga gjitarët, në zonë takohet rrallë lepuri i eger (*Lepus europaeus* Pall) e dhelpra (*Vulpes vulpes* L); lundra (*Lutra lutra* L), lakuriqi veshgjate (*Plecotus auritus*), lakuriqi i nates (*Nyctalus noctula*) etj.

Në avifaunen e rajonit në shqyrtim bëjnë pjesë shpende karakteristike të shkurretave por dhe të mjedisit urban si *Anthus campestris*, *Corone cornix*, *Corvus corax*, *Pica pica*, *Passer domesticus*, *Carduelis carduelis*, etj. Veçanërisht me të njohur janë mellenja (*Turdus merula*), gargulli i zi (*Sturnix vulgaris*), lauresha (*Aleuda arvensis*), trishtilat, harabelat, gushkuqet, si dhe turtulli (*Stroptopelia turtur* L), kumuria (*Stroptopelia decaocto* Friv).

Nga reptilet, më të pranishëm janë breshka mesdhetare e tokës (*Testudo hermanni*), gjarperi (*Natrix tessellata*), hardhuce e gjelber me tre vija (*Lacerta trilineata*), hardhuce e gjelber (*Lacerta viridis*), hardhuce (*Podarcis taurica*).

Veçanërisht prania në afërsi e lumit të Terkuzës, ka favorizuar praninë e amfibëve si bretkosen e zakonshme (*Rana ridibundo* Pall), bretkosen e vogël të ujit (*Rana lessonae*), zhaben e pemeve (*Hyla arborea*), thithlopen e zakonshme (*Bufo bufo*), thithhlopen e gjelbert (*Bufo viridis* Laur), Salamandren (*Triturus cristatus*).

Megjithatë zona nuk është nën trusninë potenciale të faktoreve të ndryshëm antropogjen, ajo nuk shquhet për praninë e koridoreve ekologjike të rëndësishme si një element tepër i rëndësishëm natyror për zhvillimit e popullatave faunistike qoftë edhe për specie të caktuara.

c. Aspekti hidrologjik e gjeomorfologjik i zonës

Lumi i Terkuzës përfaqëson një nga komponentet më të rëndësishëm hidrologjik të zonës ku vendoset objekti, si dhe një nga tre dege më të rëndësishëm të lumit Ishëm.

Lumi i Terkuzës, që nga burimi i rrjedhes përshkon formacione gjeologjike me përberie shkëmbinjë gelqeror, dhe ndër shekuj të modeluar prej tij në kanione me pamje mjaft tërheqëse të përbëra nga hinka e zgavra, veçënrisht ato mbi fshatin Priskë e vogël.

Nga studimi gjeologjik-inxhinierik dhe hidrologjik i kryer rezulton se i gjithë sheshi ku vendoset objekti përfaqëson mbushjet e terraceve të lumit të Terkuzës të përbëra nga suargjila të mesme me ngjyrë kafe e kafe të kuqërremë, të verdhë si dhe kafe të errët. Depozitimet deluvionale kanë një trashësi nga 2-3 m deri në 8-12 m dhe vendosen mbi depozitimet aluvionale dhe luajnë rolin e tapës për ujrat që kanë depozitimet aluvionale.

Nga pikpamja gjeologjike, sheshi ku vendosen objekti perfaqeson taracen e depozitimeve aluvionale të lumit të Terkuzës dhe përbehet nga suargjila zhavorore, rera dhe zhavoret si depozitime pak deri mesatarisht të konsoliduara që shkojnë në një trashësi 24 deri 30 m.

Nga studimi gjeologjik-inxhinierik dhe hidrologjik i kryer rezulton se niveli i ujit nëntokësor takohet në thellësinë 2.2 m nga sipërfaqja e tokës natyrore dhe më shumë në shtresat e rërës e zhavoreve. Nga analizat laboratorike të kryera rezulton se keto ujra janë me pH neutral, (rreth 7.6), nuk janë erodues të hekurit dhe për pasojë nuk demtojnë betonet. Ndersa uji nëntokësor që ndodhet në shtresat ranore ka veti të mira fizike e higjeno sanitare. Sipas studimit nga keto formacione mund të merret një sasi uji 1-2 litra në sekondë.

ç. Ajri, klima

Ajri

Në të gjithë territorin e Tiranës, emetimet me të evidentueshme në ajër janë ato të trafikut i cili ka një fluks në rritje dhe veçanërisht në periudhën e verës duke u ndikuar nga shkarkimet e produkteve të djegjes së karburanteve nga motorët e automjeteve. Veç kësaj pluhurat veçanërisht nga aktiviteti ndertues janë një tjetër element potencial ndotës i ajrit.

Ndërsa objekti ndodhet në një mjedis periferik të Njesisë Administrative Zall Herr, pa arritur në fshatin Pinar, ku nuk verëhen dendesi trafiku. Po ashtu dhe aktivitetet ndertimore nuk janë evidente, pasi mjedisi për rreth është rural dhe me aktivitet kryesisht bujqësor.

Temperatura e ajrite në rajonin e Tiranës është e lartë në muajt e verës (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është me e madhe, ndërsa temperatura me e ulët është në muajin Janar - Shkurt. Nga veçoritë sezonale evidentohet se gjysma e ngrohtë e vitit Prill-Shtator karakterizohet nga temperatura mesatare 20.6°C ndërsa gjysma e ftohtë 12.4°C . Ndersa ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute të ajrit është e njëjtë me atë të temperaturave mesatare, pra me një minimum në Janar dhe maksimum në Korrik ose Gusht. Temperaturat maksimale absolute $>30^{\circ}\text{C}$ fillojnë të regjistrohen që nga muaji Maj dhe vazhdojnë deri në Shtator.

Era. Rilievi i rafshet i zonës se e pozicioni gjeografik në lidhje me rajonin e Tiranës bejnë që ndikimi i Adriatikut të jetë i dukshëm si në të gjithë këtë rajon për sa i përket shpejtesisë se

eres ashtu dhe rregjimit te saj veçanënisht gjate stines se veres. Era në këtë zonë ka veçorinë e puhizes detare veçanerisht gjate periudhes së nxehte.

Ndersa gjatë vitit, drejtimi mbizoterues i eres ndryshon sipas periudhave stinore. Keshtu, gjate veres fryn era dominuese nga kuadranti i perendimit, nersa gjate dimrit fryn era nga kuadranti i lindjes. Nga të dhënat per shpejtesine e shpeshtesinë e eres per rajonin, veçojmë:

- 30 m/sek: një herë në çdo 10 vjet;
- 33 m/sek: një herë në çdo 20 vjet;
- 38 m/sek: një herë në çdo 50 vjet.

Diellezimi

Rajoni i Tiranës merr sasi te medha oresh me diell e konkretisht vlera e zgjatjes vjetore te djellezimit leviz ne kufijte nga 2600 deri 2700 ore. Po ashtu edhe numeri i diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Në muajin korrik verehen vlerat me te larta te cilat arrijnë deri ne 373 ore me diell ndersa më të ultat janë në dhjetor me 118 orë. Po ashtu koha me diell përbën mesatarisht 2221 orë/vit, nga të cilat Korrikut i përket numri më i madh të orëve me diell ndersa Dhjetorit është muaji që ka më pak orë me diell.

Reshjet

Ne rajonin e Tiranës reshjet kryesisht perfaqesohen nga shiu. Për shkak të aktiviteteteve ciklonike, shpërndarja e reshjeve është afërsisht e njëjtë ndërmjet periudhës së ftohtë dhe asaj të ngrohtë të vitit. Sasia vjetore e reshjeve është 1200 mm/vit, nga të cilat 57,2% bien në gjysmën e ftohtë të vitit.

Me më shume reshje është muaji me 132.9 mm, dhe më mujai Dhjetor me 113 mm. Ndersa muaji me më pak reshje është muaji Korrik me 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 ditë (Korrik) deri në 11.1 ditë (Dhjetor). Gjatë vitit rezulton të ketë mesatarisht 86.4 ditë me reshje ≥ 1.0 mm.

d. Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike

Rajoni i Tiranës është mjaft i pasur me objekte të një rëndësie të veçantë historike, arkeologjike e kulturore si kala, shtepia muze, rezidenca.

Ndersa linja e prodhimeve te betonit nuk ndodhet në afërsi të objekteve të tilla më rëndësi të veçantë historike, arkeologjike e kulturore ose të prek objekte të një rëndësie të tillë.

dh. Pejsazhi dhe topografia

Zona ku është instaluar impianti është e pjesë e një peisazhi të karakterit rural ku dominon aktiviteti bujqësor, ndersa ne periferi të objektit ka sipërfaqe toke të papunuara prej kohësh.

Lumi i Terkuzës që kalon në anën jugperëndimore të objektit i rritë vlerat pejsazhiste të zonës. Ndersa me vlera mjaft atraktive është kanioni me një gjatësi rreth 1200 m i përfaqësuar nga formacione gelqerore i këtij lumi që ndodhet mbi fshatin Priskë e vogël, shumë larg nga objekti.

e. Kuadri ligjor, i politikave, planeve etj

Zonat e caktuara me ligj. Nga verifikimet evidentohet se zona rreth objektit nuk klasifikohet dhe nuk përfshihet në asnjë zonë me status ligjor të veçantë mbrojtës dhe as

kufizuese e tyre për vlerat natyrore apo me objekte të rëndësishme historike e arkeologjike, arkitektonike, monument natyre etj. Gjithashtu impianti i instaluar e aktiviteti i prodhimit të betonit nga "GJONI-AN" sh.p.k. nuk ndikohet nga marrëveshje nderkombëtare, konventa etj.

3. Përshkrimi i projektit

Qellimi i zhvillimit të projektit.

Ky projekt ka si qëllim zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të artikujve prej betoni si pllaka e bordura trotuari, tuba të seksioneve të ndryshme, shtylla vreshti, puseta, blloqe, ulluqe, oxhaqe, kuneta të ndryshme. Keto artikuj janë mjaft të rëndësishëm e të kërkuar në tregun vendas sidomos për zhvillimet infrastrukturore urbane. Për të realizuar këto aktivitete, "Gjoni-AN" sh.p.k. ka ndertuar një linjë me teknologji bashkëkohore prodhimi.

I gjithë aktiviteti në këtë objekt, të gjitha proceset e punës që nga sigurimi i lendeve të para e deri në prodhimin e produktit përfundimtar që janë artikuj të ndryshëm prej betoni, bazohet në zbatimin e akteve ligjore në fuqi, standarteve bashkëkohore të prodhimit si dhe në respektimin e kërkesave ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Zona ku është ndertuar objekti, ka një pozicion mjaft të favorshëm duke ju referuar distancës me qendrën e Zall-Herrit, si dhe me Kamzën e Tiranës, të disa qendrave administrative të Bashkisë së Tiranës, të cilat ruajnë një ritëm potencial ndertimor intensiv. Në mënyrë të veçantë ka një distancë të konsiderueshme nga qendrat e banuara, fshatrat apo deri tek shtëpijat e veçuara, çfarë e bën aktivitetin e këtij objekti të pandikueshëm nëpërmjet zhurmave etj ndaj tyre. Gjithashtu aktiviteti zhvillohet në një largësi të tillë që nuk jep impakt potencial në zonat e mbrojtura bregdetare. Po ashtu ky objekt nuk ka në afërsi të tij monumente natyrore dhe objekte të një rëndësie të veçantë me karakter historik, arkeologjik e kulturor.

Alternantivat e projektit.

Nga analiza për vendodhjen dhe aktivitetin që kryen, rezultojnë se objekti përfaqëson një alternativë optimale në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat mjedisore, pa krijuar asnjë konflikt mjedisor, ose që të pengojë zhvillimin e qëndrueshëm të zonës në të ardhmen. Zona periferike ku ndodhet objekti, dominohet nga terreni i sheshtë pashfrytezuar, e më pas i shfrytezuar për aktivitet bujqësor. Ndersa pas këtij perimetri, në një distancë të konsiderueshme ndodhet ndodhet fshati Pinar.

Teknologjia e aplikuar në këtë aktivitet është bashkëkohore, nga ku rezultojnë dhe një gamë e gjerë prodhimi të artikujve prej betoni.

Teknologjia e aplikuar.

Betoni është lëndë bazë për prodhimin e artikujve me këtë lëndë si dhe sipas rastit llojet e artikujve përdoret edhe shufrat e hekurit. Kështu, betoni është material që nuk gjendet në natyrë në mënyrë të drejtpërdrejt por formohet me perzierjen e komponenteve përbërës. Kjo

teknologji nuk shoqërohet me shkarkime potenciale në mjedis për vetë natyrën e shëndrrimeve të lëndës së parë në procesin e prodhimit dhe proceseve të tjera ndihmese.

Pergatitja e betonit

Betoni pregatitet ne betonieret për këtë qëllim, në të cilat në mënyre automatike zbatohen receptura të perzierseve sipas kerkesave për prodhimin e artikujve të ndryshem.

Prodhimi i betonit realizohet nga përzierja e përbërësve të betonit, konkretisht të inerteve te fraksionuara si rërë, zall, çimento, granil, ujë në receptuara sipas kerkesave për artikuj të ndryshem. Sipas rastit në përzierje kjo teknologji mundeson të shtohen dhe përberes shtese inerte jo metalore. Çimentoja si lende lidhese pas veprimit me ujin krijon nje strukture të tillë që se bashku me masen agregate mbushese ngurtesohet në kallëpët që i japin formë artikujve të ndryshëm që prodhohen.

Të gjithë elementët inerte që marin pjesë, nuk e ndotin mjedisin rrethues ku ndodhen. Proçesi i prodhimit te betonit është proces i cili nuk shoqërohet me mbetje teknologjike. Proçesi teknologjik i prodhimit të betonit nuk ka të bëjë me ndryshime kimike të lëndës përbërëse, por vetëm me ndryshimin e cilësive fizike e mekanike të saj.

Lenda e parë

Lende e pare përbëhet nga inertet lumore, ose guri gelqeror (granile te ndryshme) që sigurohen nga tregut vendas si dhe çimento që sigurohet nga subjekte te licensuara te vendit.

Inertet me te zakonshëm që përdoren janë:

- Rerë e imet deri 5 mm;
- Granil deri 10 mm;
- Granil deri 20 mm;

Çimento e përdorur kryesisht është e markës 425 që sigurohet nga tregu vendas.

Shufra hekuri me trashesi 6 deri 14 mm nga tregu vendas.

Konsumi i lendes se pare mesatarisht 60 kv çemente, 28 m³ rerë e granil në dite. Në masën mbushëse, vendosen sipas rastit dhe shufrat metalike të lidhura me parë në zgara e forma që sherbejnë si skelet e që rrite konsistencen mbajttese të artikullit që prodhohet, soliditetin ne shtypje etj. Kjo teknologji prodhimi e artikujve prej betoni bazohet në aftesinë që ka betoni si material ne gjendje te njome te marre forma te çfaredoshme dhe ate forme ta mbaje pas ngurtesimit. Uji i përdorur në prodhimin e betonit zakonisht ka $ph=7$. Në raste te veçanta e sipas kerkesave përdoren në përzierje edhe aditivet si komponente për të permbushur cilësitë e betonit te parashtruara (me kerkesa te caktuara, psh i papershkueshem).

Betonieret janë makineritë kryesore të cilat funksionin të lidhura me silosin e çementos, depozitat e inerteve dhe linjën e furnizmit me ujë. Betoniera kryesore është e pajisur me pult komandimi per pergatitjen e betonit sipas recepturave, si dhe ka transportier per marjen e lendes se pare si dhe evadimin e betonit për ta adresuar në makineritë prodhuese të artikujve prej betoni.

Në këtë linjë janë instaluar:

- Tre betoniere, dy mbushen me vagon, ndersa nje perdor rerë 0.3 mm per shtresen e pllakave dhe të bordurave;

- Makineri për prodhim tubash, me diametër 500 - 1000 mm e m'u shum'u, (e fiksuar ne menyre te palevizshme ne mjediset e brendshme);
- Makineri për prodhim pllakash (e fiksuar ne menyre te palevizshme ne mjediset e brendshme);
- Makineri për prodhim pusetash e bordurash (e levizshme, e vendosur ne mjediset e brendshme);
- Makineri për prodhim blloqesh (e levizshme, e vendosur ne mjediset e brendshme);
- Makineri për prodhim tubash, te dimensioneve me diametër nga 150 deri 500 mm (e instaluar jashte kapanonit).

Në mjediset e linjës qarkullojnë dy mjete piru, njeri përdoret me kosh, për furnizimin me beton të makinerive, tjetri për operacionet e levizjes së artikujve në procesin e tharjes e sistemin e tyre në sheshet perkatese.

I gjithë procesi teknologjik nuk shoqërohet me shkarkime ndotëse në mjedis që lidhet më trajtimin e lëndës së parë. Kjo teknologji nuk prodhon llumra pasi nuk bëhet larja e vaskave ku bëhet perzierja e evadohet betoni pasi betoni cilësohet ndryshe i thatë (me përqindje të vogël lagështie) sa që nuk ndikon në ngjitje në enët mbajtëse si dhe kalëpet me foma të ndryshme sipas artikullit që prodhohet. Të gjitha makineritë punojnë me motora elektrik.



Fig. 1. Betonieria, makineria e prodhimit të tubave, makineria e prodhimit të tubave pllakave (nga e majta në të djathtë).

Produkti përfundimtar

Si rezultat i këtij procesi prodhohen:

- Tuba me diametër nga 200 mm deri 2000 mm;
- Bordura trotuari, harkore të dimensioneve të ndryshme;
- Puseta pa fund e kapak pusete të dimensioneve të ndryshme;
- Shtylla vreshti e dimensioneve të ndryshme;
- Puseta, blloqe, ulluqe, oxhaqe, kuneta;
- Pllakë tulle të formave, ngjyrave e dimensioneve të ndryshme;
- Konuse; oxhakë, kanalica, vazo etj



Fig. 2. Makinaria e prodhimit te pusetave e bordurave, makinaria e prodhimit te blloqeve, makinaria e prodhimit te tubave (nga e majta ne te djathte).

3. Vlerësimi i ndikimeve ne mjedis

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është bazuar në njohjen e projektit dhe teknologjise së tij, ndërhyrjeve në mjedis si rezultat i operacioneve të caktuara, njohjen e vlerave të trashëguara natyrore dhe cilësive të mjedisit të zonës, njohjen e infrastrukturës së zonës që ndërvepron me projektin, njohja me lëndet e para që konsumohen si rezultat i këtij aktiviteti.

Janë identifikuar ndikimet në mjedis që vijnë si rezultat i nderveprimit projekt - mjedis sipas receptorët mjedisore. Vleresimi i ndikimit në mjedisi të projektit synon matjen e gravitetit të ndikimeve, rëndesisë së ndikimit që lidhet bashkëveprimin projekt mjedis duke u adresuar në vlerat e mjedisit të ndikura. Gjithashtu në këtë proces është e rëndesishme dhe shtrirja fizike e ndikimit, kohëzgjatja dhe kthyeshmeria ose mundësia për t'u kthyer në gjendjen e meparshme dhe aftesia për t'u rehabilituar.

a. Ndikimi ne ujë.

Nga aktiviteti i linjës së prodhimeve të produkteve prej betoni nuk rezultojnë shkarkime ndotëse në ujrë sipërfaqësore e ato nëntoksore. Proçesi teknologjik nuk shoqerohet me shkarkime te lengeta e te rrezikshme. Ne kete proçes, uji i dozuar sipas receptures, perzihet me inertet dhe çementon ne sasinë e kerkuar per prodhimin e betonit dhe si rrjedhim nuk do te kete uje qe te dale nga procesi teknologjik dhe asnjë lëndë tjetër e perzier me ujin që të evidentohet si mbetje. Duke qënë se aplikohet beton i thatë (lagie minimale), nuk lind nevoja që me perfundimin e proçesit ose turnit të lahet vaska e betonieres, e për pasojë nuk krijohen llumra.

Aktiviteti i prodhimit të produkteve prej betoni i kësaj linje nuk ka të bëjë me ndikime në sistemin e drenazhimit të zonës pasi nuk behën shkarkime. Ky aktivitet nuk ka të bëjë me ndikime potenciale në shfrytëzimin e ujrë nentoksore sepse uji shfrytëzohet ne menyre racionale, dhe sipas teknlogjise me beton te thate, ku kerkesat për ujë janë minimale.

Zona ku ushtrohet aktiviteti është në një distancë të tillë nga bregdeti që nuk ka të bëjë me ndikime direkte ose indirekte në hidrologjinë bregdetare dhe estaurinë pasi nuk ndikon në natyrën e rrjedhjeve të ujrave. Ka vetëm shkarkime të ujrave sanitare në grope septike.

b. Ndikimi në ajer dhe klimë

Aktiviteti i linjës së prodhimeve prej betoni i subjektit "GJONI-AN" sh.p.k. nuk shoqërohet me emetime të gazeve të ndryshme në ajër që vijnë si rezultat i skemes teknologjike të zbatuar por vetëm ndikime minimale nga prania e pluhurave. Pluhurat janë të pranishëm në shesh gjatë kohës së thatë nga levizja e mjeteve në kohën e sjelljes e levizjes së materialit në sheshin e depozitimit e ndonjë rast furnizimi me çimento.

Pluhurat e mundshme që krijohen gjatë levizjes së lëndës së parë i nënshtrohen masave që kanë të bëjnë me zbutjen e ndikimit nepermjet lagies, aspirimit shoqëruar me filtrim e ajrimit të mjediseve të mbyllura.

Ky aktivitet nuk shoqërohet me emetime kimike të rrezikshme, të lëndëve të veçanta, aromave sulmuese etj. Gazet prej automjeteve përftohen në interval kohorë të shkurtra e pa ndonjë ndikime potenciale në mjedisin përreth.

c. Ndikimi në shëndetin e njerëzve

Aktiviteti nuk ka të bëjë me ndikime në shëndetin e popullatës në zonën ku ndodhet linja. Në këtë linjë prodhimi nuk përdoren ose emetohen si rezultat i teknologjisë së aplikuar të lëndëve të rrezikshme për shëndetin. Njohja e zbatimi i rregullave të sigurimit teknik si dhe zbatimi i masave zbutese e eliminuese të ndikimeve në mjedis, janë bazë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

ç. Ndikimet në florën, faunën dhe gjeologjinë

Ky aktivitet i subjektit "GJONI-AN sh.p.k. ka qënë i trajtuar sipas ligjit me autorizim mjedisor. Pas përfundimit të objektit të prodhimit, operacionet e kësaj linje gjatë funksionimit nuk shoqërohen me humbje e dëmtim të i habitateve dhe të specieve bimore e shtazore në zonën ku ndodhet. Gjithashtu nuk ka ndryshime në llojshmëri e numërin e çfarëdolloj kafshe, shpëndi apo zvaraniku si rezultat i aktivitetit e pengime në shtegtimin e kafsheve në tërësi.

Në mjedisin e zonës në afërsi nuk janë identifikuar pakësime të numrit të kafsheve të rralla dhe në zhdukje, dhe nuk verëhen të ketw ndikime më pakësimin e mjedisit fizik të kafshëve të gjuetisë. Nga ushtrimi i këtij aktiviteti nuk rezultojnë konsekuenca të tjera ekologjike, humbje e dëmtim të tipareve gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike. Në zonë nuk ka ndonjë koridor të rëndësishëm ekologjik ose habitatet me vlera të rralla natyrore që mund të ndikohet nga aktiviteti i prodhimeve prej betoni.

d. Ndikimit në energji

Nuk ka përdorimi të sasive të mëdha të karburanteve për energji por vetëm për automjetet transportuese. Nuk përdoren lëndë djegëse por energji elektrike e cila sigurohet nga rrjeti i zonës si dhe sipas rastit me gjenerator, për aktivizimin e betonieres, presave, pirunit, ndriçimit të mjediseve.

Si burim i vetëm energjie për funksionimin e linjës përdoret energjia elektrike e zonës dhe ndertimi i rrjetit nuk ndikon në regjimin e furnizimit me kete enërgji për komunitetin e zonës.

dh. Ndikimi në interesin publik

Ky impiant i prodhimit të produkteve të betonit nuk sjell ndryshime në fushat e interesit publik por ndikon fuqimisht në plotësimin e nevojave për keto llojë produktesh dhe janë mjaft të kerkuar. Nuk ka asnjë cenim te interesit publik në drejtim të përdorimit të ujit, furnizimit me energji dhe përdorimit e sigurimit të lëndes së parë. Në objekt nuk ndodhet asnjë sistem infrastrukture publike që të ndikohet në mënyrë të veçantë nga aktiviteti.

e. Ndikimi në degradime fizike

Linja e prodhimeve prej betoni nuk ka të bëjë me ndikime potenciale degraduese pasi kapaciteti shfrytëzues i burimeve natyrore si për ujin ashtu edhe inertet është në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të ndertimit e plotësimin e interesave të tjera ekonomike në përgjithësi.

ë. Ndikimi në qarkullim të transportit

Si rezultat i aktivitetit të kesaj linje nuk ka shtime të rëndësishme të levizjes së automjeteve dhe pakësim të vëndqëndrimit të automjeteve apo nevoja për vëndqëndrime të reja. Pozicioni i vendosjes së objektit është mjaft i favorshëm në minimizimin e këtij ndikimi. Po ashtu, ky aktivitet nuk shoqerohet me ndryshime në mënyrën e përditëshme të qarkullimit apo të levizjes së njerëzve, dhe ka ndodhur e kundërta pasi nepermjet ures se ndertuar nga ky subjekt mbi lumin Terkuze, është shkurtuar levizja në të dy anët e brigjeve të ketij lumi, për zonën.

f. Ndikimi nga zhurmat

Zhurmat gjenerohen krysisht nga makineritë gjatë periudhës së punës, për të cilat aplikohen masa zbutëse. Zhurmat nuk kontrastojnë në mjedisin ku ndodhen dhe për arsye te distancës se konsiderueshme nga rrugët nacionale automobilistike si rezultat i trafikut. Pozicioni i vëndndodhjes së objektit nga grup shtepiash të banuara ose ato të veçuara është mjaft i favorshëm në minimizimin e ketij ndikimi. Periudha kohore ne te cilen do te gjenerohen keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre makinerive e mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave të lejuar. Ky aktivitet nuk ndikon në një rritje potenciale të nivelit ekzistues të zhurmave pasi zhurma vleresohen në nivele të pranueshme e konform standarteve për këtë qëllim për këtë llojë aktiviteti.

g. Ndikimi në përfitimin e tokës

Aktiviteti i kesaj linjë prodhimi nuk shoqerohet me tjetërsime e shpronësime të tokës, prishje të banesave ose që të ketë komplikacione të tjera.

gj. Ndikimi në estetikën mjedisore

Objekti nuk vendosen si pjesë e cilësive të tilla mjedisore që të kontrastoje negativisht nga pikpamja estetike. Si rezultat i vendosjes se ketij objekti nuk ka ndonjë pëngesë të pamjes së horizontit nga çfarëdo kendveshtrim nga mjediset publike ose jo publike.

Vend-ndodhja e ketij objekti nuk ka lidhje me prishje të pozicionit ekzistues të një objekti tjetër me vlera të veçanta estetike mjedisore, por ndodhet larg objekteve duke mos pas asnjë ndikim të ndërsjelle midis tyre. Nga pozioni i kësaj linjë prodhimi vleresohet të mos ketë ndikime potenciale në prishje të terrenit të papranueshme estetikisht.

h. Ndikimi në trashëgiminë kulturore

Projekti i linjës së prodhimeve prej betoni në këtë zonë nuk ka bëjë më një vend me gjetje arkeologjike si dhe nuk do të ndikojë në objekte me vlera të veçanta arkitekturore. Aktiviteti i impiantit nuk do të ketë ndikime të tjera direkte ose indirekte mbi trashëgiminë kulturore etj.

4. Masat për mbrojtjen e mjedisit

a. Administrimi i mbeturinave të ngurta

Si rezultat i natyrës së procesit teknologjik në këtë linjë nuk gjenerohen mbetje të ngurta në formë sterile e të demshme për mjedisin. Fraksionet që marrin pjesë në prodhimin e betonit hidhen në betoniere sipas dozimit paraprak, pra në masen e duhur për procesin e perzierje e përftimit të betonit. Mbetjet e materialit të ngurte në paretet e kazanit të betonieres janë të pallogaritshme në sasi dhe në raste jo frekvente mbledhen e rifuten përsëri në procesin teknologjik. Sipas kësaj teknologjie pa përfitim të llumrave, nuk lind nevoja e ndertimit të vaskave dekantuese, pasi betoni trajtohet i thate.

Mbetje të tjera të cilat dalin nga aktiviteti jetesor i përditshëm i punetoreve do grumbullohen në kontener dhe me pas largohen për në vendin e caktuar nga pushteti lokal i zones konform kërkesave të përcaktuara. Për administrimin e pershtatshëm të mbetjeve duhet referuar respektimit të kërkesave të ligjit ligjit me nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit të përshatshëm mjedisor të tyre. Keto mbetje dergohen në vendet e caktuara nga Bashkia e Tiranës, Njesia Administrative Zall Herr. Për mosrespektim të ligjit të sipërpërmendur ka sanksione ligjore. Çdo qarkullim i mbetjeve për trajtim duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës konform ligjit.

b. Masat për ujrat e përdorura

Ne kete objekt nuk ka shkarkime të ujrave të përdorura teknologjike por përdorim të ujit për qëllime nevoja jetesore e sanitare. Ujrat e zeza largohen e shkarkohen në gropën septike për arsye të mungesës së rrjetit për këtë qëllim në zonë.

Në mungesë të rrjetit të ujrave të zeza për zonën duhet berë kujdes gjatë pastrimit të kësaj grope. Gropa septike duhet të pastrohet nëpërmjet subjektit të licensuar ose llumrat që dalin nga pastrimi duhet të groposen për shtratifikim e mineralizim përfundimtar, e për t'u përdorur si pleh organik në mjediset të përshatshme e të kerkuara.

c. Zbutja e ndikimi ne ajer.

Aktiviteti i prodhimeve prej betoni të kësaj linjë nuk shoqerohet me ndikime potenciale ndotese ne ajer pasi nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere sepse nuk perdor lende djegese gjate zhvillimit te aktivitetit te tij prodhues. Lenda djegese perdoret vetem nga mjetet e transportit te lendeve te para si dhe produktit perfundimtar sipas rastit. Per mbrojtjen nga gazet e motoreve të automjeteve do te merren keto masa :

- Mjetet motorike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore dhe të bëhet kontrolli e kolaudimi periodik teknik i tyre.
- Keto mjete duhet të jene te pajisura ne marmita katalitike per kapjen e gazeve toksike.

Për pakësin e eleminim e pluhurave qe krijohen gjate procesit te shkarkimit te lendeve te para, opercioneve në mjedisin e mbyllur të linjes, sidomos ne kohe te thate duhet te behet lagia e këtyre mjediseve me uje. Gjithashtu për zbutjen e ndikimeve në ajër duhet të aplikohen keto masa:

- Të behet kontrolli dhe të sigurohet që transportuesit prej gome te jenë të hermetizuar ;
- Të instalohet aspiratori në mjediset e kapanonit të linjës e të pajiset me filtra.
- Punonjesit duhet te jene te pajisur me maskat perkatese per mbrojtjen nga pluhri.

Në mjediset e jashtme të linjës janë mbjellë fidane tuje si dhe fidane ullinjë në anën veriperendimore e juperedimore. Keto punime po vazhdojnë deri ne sistemimin e plotë të mjediseve të jashtme nepermjet mbjelljes së fidanave të druveve e luleve dekorative për të ndikuar pozitivisht në cilësinë e ajrit si dhe përmirsimin e pejsazhit.

Shoqeria në mënyrë periodik duhet të tregojë kujdes të veçante per administrimin sa më të përshatshem të mjedisit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d. Minimizimi i zhurmave në mjedis.

Në këtë linjë prodhimi, burim zhurme është çdo makineri ose instalim, mjet pune, mjet transporti, ose element te zbatimit të procesit teknologjik, që lëshon zhurmë. Mbrojtja nga zhurma per zhvillimin e ketij aktiviteti duhet te sigurohet nga vet subjekti i cili ushtron aktivitetin që e gjeneron atë.

Për mbrojtjen nga zhurma, minimizimin e saj, duhet të aplikohen disa nderhyrje si ndaj instalimit që është burim i zhurmës ashtu edhe mjedisit të ndikuar për të arritur në respektimin e nivelit kufi të lejuar.

Ne këtë aktivitet, masat që do të merren nga subjekti janë:

- Realizimi periodik konform normave teknike i sherbimive mekanike për makineritë e pajisjet që gjenerojnë zhurma.

- Përdorimi i barrierave që limitizojnë përhapjen e zhurmës në mjedis, në këtë rast e rrethimit të gjelbërt.
- Makinëritë e transportit të jenë bashkëkohore e që plotësojnë standartet shtetërore, të pajisura në marmita selenciatore.
- Përdorimi nga puntoret i kufjeve, për mbrojtjen e tyre nga zhurmat,

Ligjiti me nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;

Udhëzimit me nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” përcakton nivelet e zhurmave në mjedise të caktuara, të cilat duhet të mbahen parasysh për çdo situatë.

dh. Shfrytëzimi racional i burimeve natyrore

Funksionimi i linjës së prodhimeve prej betoni ka të bëjë me shfrytëzimin e ujit për prodhimin e betonit si dhe për ujë të pijshëm nga rrjeti i furnizimit për këtë qëllim, nepermjet kontratës me Ujësjetellës Kanalizime Tiranë, sh.a. Duhet të merren të gjitha masat për mos shpërdorim të ujit por për përdorim sa më racional të tij.

Një produkt tjetër që shfrytëzohet nga burimet natyrore janë inertet, rerat e granilet. Furnizimi me inerte duhet të bëhet vetëm nga subjekte të licenciuara me qëllim shmangien e shfrytëzimeve abuzive të inerteve lumore e karrierve të tjera.

e. Kërkesat teknike, estetike e ekologjike

a - Masa teknike:

- Respektimi i kritereve teknike të operacioneve teknologjike e të ngarkim shkarkimit.
- Zbatimi i shesheve të distancave të sigurore prej elementeve të infrastrukturës së sheshit etj, mbrojtja rigoroze e përmirsimi i saj.
- Respektimi i plotë i Regullores së Sigurimit Teknik që lidhet dhe me mënyrën e zgjidhjeve teknike e zbatimit të tyre të të gjitha operacioneve të punës.
- Kryerja periodike e rimonteve të makinerive, automjeteve e të mekanizmave që mund të shtohen në të ardhmen në kryerjen e këtij aktiviteti, zëvendesimet e pjesëve të amortizuara, rehabilitimet konform respektimit të kërkesave të markave të zgjedhura me qëllim ndalimin e aksidenteve të punës.

b – Masa estetike e ekologjike

- Vendet e depozitimit të lëndës së parë kryesisht të reres e granileve duhet të mbahen vazhdimisht të sistemuara, duke eliminuar mundësinë e ndikimit mbi to të reshjeve që do të çonte në rrjedhje të tyre drejt kanalizimeve apo të erërave.
- Parashikimi dhe marrja e masave urgjente në raste avarinash me qëllim parandalimin e ndikimeve tek punonjësit, banoret e mjedisin për rreth.

- Zbatimi koherent i masave që lidhen me ruajtjen e parametrave teknik e ligjor që kanë të bëjnë me ndikimet e mundëshme në ajër, ujë e në shendetin e njerëzve sipas aktivitetit që zhvillohet. Marrja e masave përkatëse në rastet e konstatimit të ndotjeve.
- Mbjellja e shërbimi në vijimësi i fidaneve të përshtatshëm bimor në këndet e gjelbërta e hapësirat e caktuara brenda krejt objektit ku zhvillohet aktiviteti, ripërtitja e përmirsimi i krejt vegjetacionit në me qëllim uljen e impakteve në aspektin ekologjik dhe estetik. Keto përmirsime kanë të bëjnë dhe me zbutjen e ndikimeve në pejsazh, ajër, zhurma etj.

ë. Parandalimi i rreziqeve

Për parandalimin e rreziqeve, aktiviteti duhet të mbështetet në Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjen në Punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatimin e tyre të lëshuar nga dikasteret përkatëse.

Subjekti duhet të përcaktojë si detyre ligjore vendosjen e tabelave në vënde të dukshme dhe natën të ndriçuar me pjesët kryesore të rregulloreve të sigurimit teknik, sigurimin e kushteve e mjeteve mbrojtëse. Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë do të jenë ndër problemet me kryesore për subjektin gjatë gjithë ushtrimit të aktivitetit.

Situatat e veçanta që mund të krijohen nga mosnjohja e kushteve teknike të punës, pakujdesite e ndryshme kërkojnë një vlerësim maksimal të masave mbrojtëse e respektimin e rregullores së sigurimit teknik.

Në kryerjen e të gjitha operacioneve të punës, duhet të punësohen specialistë me eksperiencë e të kualifikuar në përputhje me kërkesat e vendit të punës. Operacionet e punës duhet të drejtohen nga person i kualifikuar i cili do të zbatojë rregullat e përcaktuara në rregulloren e teknikes së sigurimit për çdo rast.

Në këtë rregullore përcaktohen:

Detyrimet e punëdhënesit

Punëdhënesi vetë ose nepermjet drejtuesit teknik duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Pajisjet dhe automjetet që përdoren në operacionet e ngarkim shkarkimit.
- Shkaqet e aksidenteve dhe masat për menjanimin e tyre sipas specifikës së aktivitetit.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të lëshuara nga dikasteret që lidhen me to.
- Veçoritë e punës në, rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes për menjanimin e aksidenteve sidomos në kushte të veçanta (reshje, lageshtire etj).
- Rregullat e sigurimit teknik që lidhen me proceset e punës, makineritë dhe profesionin që kryen punëmarrësi, për mbrojtjen e vetes dhe punonjesve të tjerë, të cilët kryejnë këtë aktivitet ose të tjerë që janë vizitore.
- Ndihmen e parë shëndetsore
- Të kryejnë instruktim paraprak dhe periodik të punonjesve, dokumentat sipas formularit të përcaktuar në rregulloren e sigurimit teknik për operacione specifike ngarkim shkarkimi.

Detyrimet e punëmarrsit:

- Të njohë mirë përdorimin e pajisjeve dhe makinerive për shfrytëzimin e tyre.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të publikuara nga Inspektoriati i Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Punës.
- Të dije mirë shkaqet e mundeshme të aksidenteve për çdo proces pune.
- Të siguroje vehtën e punonjesit e tjerë gjatë procesit të punës.
- Kur konstaton shenja të një avarie të mundëshme që është burim aksidenti, në radhë të parë, merr masa për eliminimin e saj, ndërkohë lajmëron gjithë punonjesit për rrezikun.
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.

Administratori, duhet të manë masa për trainimin e personelit për nderhyrje të shpejtë në rast avarish gjatë procesit të punës sipas kërkesave të MNZ-se.

Administratori duhet të zbatojë me rigorozitet kërkesat e MNZ-se për të përfshirë brenda këtij projekti vendosjen e fiksive brenda ambienteve të punës.

5. Monitorimi

Qëllimi i monitorimit mjedisor për veprimtarinë e projektit është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse operimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standartet mjedisore që lidhen me të, si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Monitorimi i treguesve mjedisor për këtë aktivitet siguron të dhëna nëpërmjet të cilave vlerësohet nëse kjo veprimtari zhvillohet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor mjedisor dhe standartet që janë përcaktuar në këtë legjislacion. Monitorimi ndihmon të vlerësohet performanca e menaxhimit mjedisor për këtë aktivitet me synim përmirësimin e vazhdueshëm. Konkluzionet e monitorimit të ndikimeve në mjedis të veprimtarisë ndihmojnë për nxjerrjen e konkluzioneve të sakta për të kryer ndërhyrjet e nevojshme për respektimin e standarteve mjedisore dhe rritjen e performancës mjedisore të këtij aktiviteti.

Monitorimi për këtë aktivitet do të fokusohet në:

- Monitorimin e gjendjes së makinerive të linjës;
- Monitorimin e ngritjes së pluhurave në linjen e prodhimit;
- Monitorimin e filtrave të pluhurave të vendosura në rruget e aspiratorit dhe ndërrimi i tyre në rast demtimi ose mosfunksionimi;
- Monitorimin e zhurmave;
- Monitorimin periodik të cilësive fizike - kimike të ujërave përdorura nga larjet e mjedisve të punës.
- Monitorimin e funksionimit të kanalizimit drenues të mjedisve të objektit dhe kontrolli i largimit të ujërave të shiut nga sipërfaqja e objektit;

Subjekti duhet të vlerësojë me përparësi monitorimin e të gjithë masave të parashikuara për zbutjen e ndikimeve.

6. Konkluzione

Aktiviteti i linjes së prodhimeve prej betoni i subjektit "GJONI-AN" sh.p.k. zhvillohet pa ndikime potenciale negative në mjedisin e zonës.

Ndikimet nga ky aktivitet janë të pranueshme referuar natyrës së aktivitetit, teknologjisë që përdoret dhe ka të bëjë me ndikime në ndryshimin e peisazhit të sipërfaqes ku është instaluar por pa kontrastuar me objektat e vlera të kësaj zone. Për arsye të distancave të konsiderueshme e mjaft të favorëshme të këtij objekti me objektet e tjera infrastrukturore, natyrore e urbane, vend-ndodhja konsiderohet e favorëshme dhe aktiviteti kontribuon pozitivisht në parametrat zhvillimor të kësaj zone e më gjërë.

Aktiviteti i kësaj linje të prodhimit të artikulave betoni, bazuar në teknologjinë e aplikuar nuk shoqërohet me shkarkime të lëngut në mjedis. Ujrat që përdoren në këtë linjë nuk kanë tepër nga përbërësit e lëndës së parë, pasi sasi të përcaktuara me parë se të marrin pjesë në procesin e përfundimit të betonit.

Edhe ujrat që përdoren për mirëmbajtje janë të pakontaminuara dhe nuk kanë ndikim ndotës në tokë, në ujrat sipërfaqësore e nëntokësore, sepse në mjedisin e këtij aktiviteti kemi të bëjë vetëm me inerte.

Në asnjë hallkë të këtij aktiviteti nuk përdoren lëndë të rrezikshme që të ndikojë negativisht në shëndetin e punonjësve si dhe të popullsisë përreth zonës.

Aktiviteti i kësaj linje nuk sjell emetime të gazeve në atmosferë pasi nuk kemi procese të shëndritimeve kimike të lëndës së parë por vetëm përzierje të ndryshme fizike. Gjatë procesit të shkarkimit të materialit në shesh, si dhe në sallën e makinerive bëhet pluhur i lehtë dhe

drejtuesit e subjekti ka marrë masa ne vendosjen e aspiratorit ne kete mjedis si dhe lagien. Administratori duhet të pajisë puntoret me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri si kominoshe pune, kapele mbrojtese, maska për mbrojtjen nga pluhuri, doreza pune.

Zhurmat e gjeneruara nga makinerit e linjës së prodhimeve të betonit rezultojnë në nje nivel të pranueshem në sfond si dhe përdorimi i kufjeve për punonjesit pranë makinerive zbut ndikimin e tyre në këtë drejtim.

Impianti elektrik i instaluar, e plotesimi i kushteve teknike të lidhjes ne rrjetin elektrik të zonës nuk ka ndikuar ne keqfunksionimin e furnizimit me energji të komunitetit të zonës pasi ky objekt ka linjë të dedikuar.

Ky raport u përgatit nga:

JAK GJINI
EKSPERT MJEDISI

Jak GJINI

EKSPERT MJEDISI

Per **KLUBIN EKOLOGJIK**



Zef YMERI

KRYETAR

Çertifikuar sipas Vendimit Nr. 10, datë 24.07.2008, me nr. 531 Prot. nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave sot Ministria e Mjedisit.

Çertifikuar sipas Vendimit Nr. 3, datë 20.04.2006, me nr. 224 Prot. nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave sot Ministria e Mjedisit.